

E nderuar Znj. Kapaj,

Ju bëjmë me dije se kërkesa juaj për informacion, (Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit) është regjistruar me nr.1042/6 prot, datë 11.01.2021, në lidhje me kërkesën për informacion, për subjektin e vlerësimit Z. Xhavit Shala.

Kërkesa është shqyrtuar nga Autoriteti më datë 21.01.2021 duke i kaluar për kompetencë e zgjidhje ligjore kordinatorit për të drejtës për informim.

Në lidhje me kërkesën tuaj ju bëjme me dije se, në rastin konkret ndodhemi përpara kufizimeve që parashikon neni 17 i ligjit nr 119/2014 “Për të drejtën e informimit

Në referim të ligjit nr 119/2014 “Për të drejtën e informimit” neni 17 pika 2 gërma “dh”, parashikohet se “E drejta e informimit kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit shkakton një dëm të qartë dhe të rëndë ndaj interesave të mëposhtëm: dh) barazinë e palëve në një proces gjyqësor dhe mbarëvajtjen e procesit gjyqësor”. Duke qenë se dosja aktualisht ndodhet pranë Gjykatës së Rrethir Gjyqësor Tiranë e cila do të vendosë përfundimisht për shkaqet e kërkesës së paraqitur nga subjekti kërkues, dhënia e informacionit Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit, do të konsiderohej nga subjekti i vlerësimit si shkelje në shkallët e gjykimit.

Autoriteti vlerëson se çdo kërkesë për informacion/të dhëna, kur ato gëzojnë mbrojtje ligjore, qoftë në kuadër të ligjshmërisë dhe respektimit të parimeve të procesit, qoftë të garantimit të të drejtave kushtetuese të palës në proces, nuk mund t'i vihen në dispozicion Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit.

Bazuar në nenin 14, të ligjit nr.119/2014, “Për të drejtën e informimit” dhe nenit 31/1/c, të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2018, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, dhe në respektim të parimit të proporcionalitetit, Autoriteti ka publikuar dhe bërë transparent informacionin e nevojshëm, në faqen e tij zyrtare lidhur me vendimmarrjen pas kryerjes së verifikimit të parë.

Bazuar në nenin 17 të ligjit nr.119/2014, “Për të drejtën e informimit”, informacioni i kërkuar bën pjesë në kategoritë e informacionit që kufizohet të jepet.

Duke ju falenderuar

**Kordinatori i të drejtës për informim pranë AIDSSH
Selami Zalli**

E-MAIL: selami.zalli@autoritetidosjeve.gov.al.